



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2021:094779
Datë: 14.06.2024
Numri i dokumentit: 05823132

2021:094780 (C.nr.1025/21)

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Armend Ahmeti, në çështjen juridike kontestimore të paditësit E.K. nga fshati ..., Komuna Ferizaj, të cilin me autorizim e përfaqëson avokat Zejnije Bega nga Ferizaj, kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë – Drejtoria Rajonale në Ferizaj, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore në Ministrinë e Drejtësisë të Republikës së Kosovës, me objekt kontesti kompensim i pagës së trembëdhjetë, me lartësi të objektit të kërkesës 2,078.64€, jashtë seancës gjyqësore me datë 14.06.2024, mori dhe përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar** kërkesëpadia e paditësit E.K. nga fshati ..., Komuna Ferizaj dhe **DETYROHET** e paditura Ministria e Punëve të Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë – Drejtoria Rajonale në Ferizaj, që paditësit në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë për vitet 2018 t'ia paguaj shumën 692.88€, për vitin 2019 t'ia paguaj shumën 692.88€, e që në shumën e përgjithshme 1.385.76 me kamatë ligjore prej 8%, e cila fillon të llogaritet nga dita e paraqitjes së padisë 19.05.2021 e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e kësaj procedure kontestimore, ne shumën prej 134,00, të gjitha këto afat prej 7 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nen kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.
- II. REFUZOHET** pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit E.K. që ka kërkuar në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë për vitin 2020 t'ia paguaj shumën 692.88€.

A r s y e t i m

Paditësi përmes përfaqësuesit të tij av. Zejnije Bega nga Ferizaj, me datën 19.05.2021, ka paraqitur padi kundër të paditurës, me anë të cilës ka kërkuar shpërblimin e shpenzimeve të shuajtjes, pagën e trembëdhjetë dhe pagën jubilarë. Në padi ka theksuar se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, përkatësisht në Policinë e Kosovës, në punët dhe detyrat e Zyrtarit Policor në Ferizaj ku edhe më tutje vazhdon të punojë. Paditësi, që nga data 17.01.2005 ka vlerësim plotësisht të kënaqshëm, e po ashtu nuk ka asnjë masë disiplinore të shqiptuar, ku si prove është formulari i vlerësimit të performancës. Më tutje ka theksuar se paditësi i ka plotësuar kushtet për pagën e fund vitit mbështetet në vërtetimet e lartcekura ndërsa baza juridike e

kërkesëpadisë mbështetet në Udhëzimin Administrativ, nr.02/2018, mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, e cila është në fuqi që nga data 14.11.2018, përkatësisht në kapitullin e VI Paga dhe Sistemimi i Personelit të Policisë, ku në nenin 29, paragrafi 2, parashihet se "Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit. Meqenëse paditësi ka dëshmuar se nga viti 2018, (vit i cili Udhëzimi i lartcekur është në fuqi dhe ua njeh këto të drejta), i njëjti ka vlerësim plotësisht të kënaqshëm dhe i njëjti nuk ka asnjë masë disiplinore gjatë këtyre viteve, andaj të njëjtit në emër të pagës së trembëdhjetë i takojnë tri paga mujore në total shuma prej 2,078.64€. Nga të cekurat e lartpërmendura Paditësi u detyrua që me padi ti drejtohet Gjykatës Themelore në Ferizaj me qëllim të realizimit të pagës së fund vitit. Përmes parashtrësës së dorëzuar në gjykatë më dt. 27.12.2023 përfaqësuesi i autorizuar i paditësit e ka precizuar kërkesëpadinë, ashtu që ka hequr dorë nga kërkesa për kompensimin e shujtës ditore, duke mbetur vetëm pranë kërkesës për pagën e trembëdhjetë. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura nëpërmjet përfaqësuesit ligjor – avokaturës shtetërore pranë Ministrisë së Drejtësisë me datë 11.12.2023, ka paraqitur përgjigje në padi me të cilën e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të palejuar: mbështetur në dispozitën e nenit 78 paragrafi 1 të Ligjit nr. 03/L-212 i Punës (Mbrojtja e të drejtave për të punësuarit 1. I punësuarit i cili vlerëson se punëdhënësi ka shkelur të drejtën e marrëdhënies së punës, mund të paraqesë kërkesë të punëdhënësi apo organi përkatës i punëdhënësit nëse ekziston, për realizimin e të drejtave të shkelura. 2. Punëdhënësi është i obliguar për të vendosur sipas kërkesës së të punësuarit, në afatin brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e pranimin të kërkesës. 25 3. Vendimi nga paragrafi 2. i këtij neni, i dorëzohet të punësuarit në formë të shkruar brenda afatit prej tetë (8) ditësh. Ministria e Financave në përputhje me nenin 19 të Ligjit nr. 07/L-041 mbi ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2021, përkatësisht ligjin nr. 05/L-125, në nenin 20 par 4 për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2017 nuk e ka aprovuar kërkesën e Policisë së Kosovës dhe si rrjedhojë e kësaj çdo veprim apo nismë duke përfshirë edhe nenin 29 par 2 të UA. nr. 02/2018 Për marrëdhënien e punës në Policinë e Kosovës, i cili prodhon obligime financiare nuk është i obligueshëm përderisa nuk e ka identifikuar paraprakisht burimin financiar, ashtu që në mungesë të mjeteve buxhetore financiare nuk ka mundur të realizohet pagesa e pagës së 13-të. Sa i përket kërkesëpadisë së paditësve për kompensimin e pagës së 13-të, shujtave, shpenzimet të udhëtimit për çdo vit kalendarik e kundërshtojmë pasi që kjo vlen vetëm në bazë të mundësive ligjore, financiare dhe institucionale të të paditurës dhe asnjë dispozitë ligjore nuk parasheh si detyrim, andaj e njëjta nuk mund të jetë obligim i të paditurës, e paditura ndaj paditësve të vetmin detyrim ligjore e ka përmbushjen e Kontratës së Punës e cila konsiderohet ligj për palët. Paditësi do të mund të kompensohej për pagën e 13-të dhe shujta, brenda mundësive institucionale ligjore dhe financiare, andaj deri më tani këto mundësi nuk janë krijuar, që nënkupton se nuk është detyrim për të paditurën.

Gjykata ka vendosur si në pikën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi bazuar në nenin 398 të LPK i cili parasheh se: "Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të

cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë.” Ndërsa gjykata ka vendosur si në pikën II. të dispozitivit të këtij aktgjykimi bazuar në nenin 399 të LPK i cili parasheh se: “399.1 Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadija. 399.2 Kërkesëpadija është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadija qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura.” lidhur me nenin 149 të LPK i cili parasheh se: “149.1 Në qoftë se paditësi, deri në përfundimin e seancës për shqyrtim kryesor të çështjes, heqë dorë nga një pjesë e kërkesëpadiës apo nga e gjithë kërkesëpadija, gjykata pa shqyrtim të mëtejshëm e jep aktgjykimin me të cilin e refuzon kërkesëpadinë në pjesën nga e cila paditësi ka hequr dorë apo në tërësi (aktgjykimi në bazë të heqjes dorë”.

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës dhe vlerësimi i përgjigjes në padi, gjykata konstatoi se në mes të palëve ndërgjyqëse nuk është kontestuese se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura, megjithatë gjykata këtë e vërtetoi edhe nga vërtetimi i punësimit të paditësit, dhe është i bashkangjitur në shkresa të lëndës. Nga vërtetimi i punësimit i datës 15.04.2021, të lëshuar nga MPB– Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, gjykata ka vërtetuar se paditësi, ishte i punësuar me orar të plotë në Policinë e Kosovës që nga data e 17.01.2005, dhe paga e fundit të tij ka qenë 692.88€, për një muaj kalendarik. Gjykata vlerëson se në këtë rast duhet të zbatohen dispozitat e Udhëzimit Administrativ nr. 02/2018 dhe UA nr. 01/2021, mbi marrëdhënien e punës në Policinë e Kosovës, për kërkesën e aprovuar të paditësit, që kanë të bëjnë me kompensimin e pagës së 13-të respektivisht për vitet 2018 dhe 2019. Me nenin 29 paragrafi 2 të UAA nr. 02/2018 përcaktohet se 2. *”Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit.”*. Nga interpretimi i dispozitave të Udhëzimeve Administrative 02/2018, të nxjerra nga e paditura, dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadija e paditësit është pjesërisht e bazuar pasi që gjykata vlerëson se paditësi e gëzon të drejtën që në fund të çdo viti kalendarik, ta përfitoj si shpërblim, një page mujore, e cila pagë do të jetë e njëjtë me pagën mujore në fund të vitit kalendarik përkatës, me kusht që atë vit kalendarik punonjësit e të paditurës, në këtë rast paditësi, të ketë vlerësim të kënaqshëm të performancës së punës dhe nëse nuk ju është shqiptuar ndonjë masë disiplinore brenda vitit përkatës. Me rastin e vendosjes lidhur me lartësinë e kompensimit për shpërblimin e pagës së fund viteve 2018 dhe 2019, në rastin konkret për paditësin, gjykata mori për bazë vërtetimin e punësimit të vlerësuar si më lart, e nga e cila rezulton paga të cilën e realizon paditësi dhe përvojën e punës tek e paditura, andaj paditësit ju njoh e drejta në kompensim ashtu siç është në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Në këtë rast sipas formularëve të vlerësimit, që gjenden në shkresat e lëndës, konstatohet se paditësi, ka vlerësim të kënaqshëm të performancës dhe të njëjtit nuk i është shqiptuar ndonjë masë disiplinore, përgjatë viteve 2018, dhe 2019. Për më tepër e paditura nuk ka parashtruar ndonjë vërejtje me anë të përgjigjes në padi, e që do të vinte në dyshim performancën e paditësit për vitet e kaluara, e po ashtu nga e paditura nuk është ngritur as çështja e ndonjë mase disiplinore eventuale të shqiptuar ndaj paditësit. Ashtu që, gjykata vlerëson se paditësi ka të drejtë që të kërkojë pagën e trembëdhjetë, duke u mbështetur edhe në dispozitat nën – ligjore respektivisht Udhëzimin

Administrativ të cekur më lartë i cili në mënyrë të qartë e përcakton të drejtën e paditësit për të marrë pagat të përshkruara në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Gjykata, vlerëson se e paditura ka detyrim sipas dispozitave të lartpërmendura, që t'i kompenzoj paditësit pagat e trembëdhjeta duke u bazuar në nenin 245 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD). Prandaj gjykata duke u nisur nga fakti se e paditura ju ka mbetur borxh paditësit me aplikimin e dispozitave të lartcekura dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, vendosi që ta detyroj të paditurën që paditësit t'ia kompenzoj shumat e gjykata si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Gjykata e refuzoi pjesën e kërkesëpadisë që në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë për vitet 2020 t'ia paguaj shumën 692.88€, për shkak se paditësi nuk ka sjellë prova që vërtetojnë se i njëjti në këtë periudhë të vitit 2020 kishte performancë të knaqëshme dhe nuk ka të shqiptuar ndonjë masë disiplinore, pra nuk ka sjellë vlerësimin e performancës për vitin 2020 andaj edhe gjykata është e lidhur me materialin provues që palët e prezantojnë para gjykatës.

Për lartësinë e kamatës në shkallë prej 8%, gjykata vendosi në bazë të nenit 382 par 2 i LMD-së, dhe Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme për kamatat të datës 02.12.2020.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet e të paditurës në përgjigje në padi dhe gjeti se të njëjtat janë te pa bazuara. E paditura nuk mund ta mënjanoi detyrimin, me pretendimin se detyrimet financiare nga Udhëzimi Administrativ se nuk prodhojnë efekt për shkak se nuk janë në harmoni me Ligjin mbi ndarjet buxhetore, gjykata vlerëson se këto akte, në këtë rast Udhëzimet Administrative të lartcekura, janë aprovuar nga struktura të larta të të paditurës, e të cilët e kanë pasur për qëllim edhe motivimin e punonjësve për punë kur edhe kanë përcaktuar shpërblime për të njëjtit. Për më tepër derisa ato janë qartë të specifikuara nuk mund të interpretohen në dëm të tani paditësve duke u thirrur në ekzistimin e mundësive financiare, e as nuk mund të mbetet në diskrecionin e të paditurës se a mundet a po jo për tu përmbushur detyrimet që rezultojnë nga dispozitat lartcekura, përderisa e paditura me asnjë provë shkresore – analizë buxhetore, nuk e argumenton faktin se ka mungesë të mjeteve buxhetore për përmbushjen e detyrimeve siç kanë kërkuar paditësi, për pjesën e aprovuar të kërkesës.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitën e nenit 449, 452 dhe 463 të LPK-së, sipas të cilave paditësit i pranohen shpenzimet e procedurës kontestimore dhe atë 104,00€ në emër të përpilimit të padisë, dhe në emër të taksës gjyqësore në shumën prej 30,00€.

Nga se u tha me lart, gjykata konform nenit 143 të LPK vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjyqtari Armend Ahmeti

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.